

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"IMOBILIARE SERVIS" SH.P.K

Në mbështetje të Nenit 230, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe Nenit 28, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar, sot më datë 07.12.2021, Ortaku i Vetëm:

-Z. Sokol Meqemeja, shtetas shqiptar, lindur më 28.06.1969, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportësme Nr. Personal: G90628152K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut zotërues të 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Ka vendosur të nënshkruajë Aktin e Themelimit të mëposhtëm, për krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj.

NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË

- 1.1** Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "**Imobiliare Servis**" sh.p.k., në vijim referuar si "*Shoqëria*".

NENI 2
BAZA LIGJORE

- 2.1** *Shoqëria* do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 2.2** Kjo *Shoqëri* fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

NENI 3
SELIA

- 3.1** Selia kryesore e aktivitetit të *Shoqërisë* është në adresën: Rruga e Elbasanit, Vila Nr.71, Njësia Administrative Nr. 2, Tiranë, Shqipëri.

- 3.2 Shoqëria mund të hapë filiale, degë përfaqësie ose agjensi në varësi të saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë në çdo kohë që çmohet e arsyeshme prej saj dhe me aprovimin e organeve kompetente.

NENI 4 OBJEKTI

- 4.1 Objekti i veprimtarisë së *Shoqërisë* përfshin sa më poshtë vijon:

Aktivitet në fushën imobiliare, shit-blerje, posedim, dhënie me qira, administrim, rehabilitim, promovim, menaxhim i pasurive të paluajtshme duke përfshirë: zona rezidenciale, zyra, parqe biznesi, qendra tregtare, magazina, hotele, shtëpi banimi, etj.

Ndërmjetësim në lidhje me transaksione tregtare me objekt shit-blerjen, dhënien me qira, investimin dhe/ose zhvillimin e pasurive të paluajtshme.

Ofrimin e konsulencës juridike në lidhje me realizimin e objektit të veprimtarisë së saj.

Çdo aktivitet tjetër të dobishëm ose të nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të saj ose që ka lidhje me të në kuptimin më të gjerë të fjalës.

NENI 5 KOHËZGJATJA

- 5.1 Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë është me afat të pacaktuar.

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

- 6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, përpara regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 6.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë.
- 6.3 Pjesët e kapitalit zotërohen nga Ortaku i Vetëm si më poshtë:

-Z. Sokol Meqemeja zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, e cila përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të shoqërisë.

NENI 7

TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

- 7.1 Pjesët e kapitalit themeltar janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara në Statutin e shoqërisë dhe në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", *i ndryshuar*.

NENI 8 ADMINISTRIMI

- 8.1 Emërohet si Administrator i Shoqërisë **Z. Sokol Meqemeja**, shtetas shqiptar, lindur më 28.06.1969, në Tiranë, banues në Tiranë, mbajtës i Pasaportës me Nr. Personal: G90628152K, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- 8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", *i ndryshuar* dhe dispozitave të Statutit të shoqërisë.
- 8.3 Administratori është i autorizuar të veprojë në emër të *Shoqërisë* në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.
- 8.4 Administratori do të qëndrojë në detyrë për 5 (pesë) vjet dhe gëzon të drejtën e riemërimit në këtë detyrë pas përfundimit të mandatit të tij.

NENI 9 DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 9.1 Çështjet që nuk trajtohen në këtë Akt Themelimi, rregullohen në Statutin e *Shoqërisë* si dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.
- 9.2 Ky Akt Themelimi është hartuar në Tiranë, Shqipëri në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha të njëjtën fuqi ligjore.

ORTAKU SHOQËRISË

"IMOBILIARE SERVIS" SHPK

SOKOL MEQEMEJA

